



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ....44..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 27/04/2022

**VENDIM**

Nr.11, datë 27 /04/2022

**PËR**

**RAPORTIN VJETOR TË VITIT 2021 PËR OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE  
KONTROLLIN E DIGAVE TË HEC BANJËS DHE HEC MOGLICËS QË  
SHFRYTËZOHEN NGA KOMPANIA DEVOLLI HP**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 27.04.2022 mori në shqyrtim Raportin vjetor për vitin 2021 në lidhje me Shfrytëzimin, Monitorimin dhe Sigurinë e Digave të Mëdha të HEC Banjës dhe HEC Moglicës që shfrytëzohen nga kompania DEVOLLI HP. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ardhur rezultonte se Raporti vjetor përmbante vetëm rezultate të monitorimit aktual të digave të HEC Banjës dhe HEC Moglicës dhe nuk jepete informacion sipas kërkesave të KKDM të dhëna në Janar 2022 në lidhje me gjëndja aktuale të të gjithë elementeve kryesore të këtyre digave dhe ujëmbledhësave të krijuar prej tyre, informacion në lidhje me problematikat kryesore të hasura gjatë vitit 2021, informacion për projektet apo investimet e kryera në digë dhe në ujëmbledhës si dhe programin për vitin 2022, Analiza dhe konkluzione të shfrytëzuesit të digës në lidhje me zhvillimet e situatave gjatë vitit 2021. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

**VENDOSI:**

1- Ti kërkojë Shoqërisë Devolli Hydropower

- Të pregatit dhe të dorëzoj brenda muajit Korrik 2022, pranë KKDM informacion në lidhje me gjëndjen aktuale të të gjithë elementeve të digave të HEC Banjës dhe HEC Moglicës si dhe të Ujëmbledhësave të krijuar prej tyre. Në këtë informacion të jepen edhe analizat dhe konkluzionet e shfrytëzuesit të digës në lidhje me zhvillimet e situatave gjatë vitit 2021
- Të pregatit dhe të dorëzoj brenda muajit Korrik 2022 informacion në lidhje me problematikat kryesore të hasura gjatë vitit 2021 si dhe investimet apo studimet e kryera gjatë vitit 2021. Në këtë informacion mund të përfshihet edhe programi i masave që janë parashikuar gjatë vitit 2022 për mirëmbajtjen, monitorimin dhe sigurinë e të dy digave.
- Të pregatit dhe të dorëzoj për shqyrtim brenda muajit Tator 2022 në KKDM një Raport të vlerësimit dhe menaxhimit të aseteve të digave të HEC Banjës dhe HEC Moglicës. Ky Raport duhet të përfshijë informacion për gjëndjen aktuale të digave dhe të performancave të tyre, jeten e shërbimit të mbetur, rreziqet që kaë këto diga dhe vlerësimin e tyre, planin strategjik për sigurinë, monitorimin dhe mirëmbajtjen e tyre, etj.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kerkuara në kete Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**  
Arjan JOVANI

